



Pranimi / Doretuar Priljeoni/Pril dato Received/Delivered		06.04.2022	2 viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHAK	1930/2022		1/4



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 160/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca -anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.160/2022, të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia Kundër Korrupsionit, në çështjen juridike “vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.04.2022, mori këtë.

#### V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa A.nr.160/2022, e datës 23.02.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. ANULOHET vlerësimi i rezultateve në punë, për vitin 2021, i datës 08.02.2022, vetëm sa i përket objektivës së 3 (tretë) të vlerësimit.
- III. Vlerësimi Vjetor i vitit 2021, për ankuesen konsiderohet vlerësim i “Mirë” tek objektiva 3 (tretë) .
- IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i AKK, dhe Menaxheri i Personelit, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- VI. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetari i Kolegjit.

## Ar sy e t i m

Ankuesja [redacted] me datë 23.02.2022, me numër protokoli 953/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2021, të vlerësuar nga Shefi i Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë më arsyetim se vlerësimi vjetor, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia Kundër Korrupsionit. Ndërsa me datë 11.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.02.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoli 945/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezolutave në punë i datës 08.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezolutave në punë i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezolutave në punë i vitit 2019; Formulari për vlerësimin e rezolutave në punë i vitit 2017; Formulari për vlerësimin e rezolutave në punë i vitit 2020; Akt Emërimi me numër protokoli 01-2177/13 i datës 22.07.2013, i ankueses [redacted] Përshkrimi i Detyrave të Punës; e- maili i datës 03.12.2021; Përcaktimi i objektivave detyrat e punës për vitin 2021; Përgjigje në ankesë me numër protokoli 1301/2022 e datës 11.03.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses [redacted] se vlerësimi vjetor i punës për vitin 2021, i bërë nga Shefi i Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim Publik, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi që ka analizuar të gjitha shkresat dhe faktet relevantë lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka konstatuar se pretendimet e ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë, janë të qëndrueshme vetëm sa i përket pikës (tretë) të vlerësimit, tek "Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit".



Bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen Kolegji konstaton se ankuesja është vlerësuar nga Shefi i Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim Publik, me notën e përgjithshme dy pike tridhjetë e gjashtë (2.36), i cili vlerësimin është bërë me datë 31.01.2022, ndërsa në formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nënshkruar me datë 08.02.2022, del se ankuesja është vlerësuar me notën e përgjithshme dy pike shtatëdhjetë e tetë (2.78). Ndërsa sa i përket pikës së 3 (tretë) të vlerësimit tek "Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit", mbikëqyrësi ka vlerësuar me notën 1 ankuesen që për Kolegjin nuk është i qëndrueshëm ky vlerësim në këtë pikë, sepse mbikëqyrësi para se të bëjë vlerësimin përfundimtar të ankueses, sipas nenit 7 "Vlerësimi i progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime më nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme" të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Nëpunësve Civil...", prandaj bazuar në shkresat e lëndës që ka dërguar si provë AKK nuk ka ndonjë dëshmi që mbikëqyrësi i ankueses të këtë bërë ndonjë vlerësim të progresit të arritur lidhur me realizimin e objektivave.

Prandaj sipas Kolegjit është vlerësim i pa qëndrueshëm, vlerësimi me notën 1 të ankueses tek pika kryesore e përshkrimit të punës dhe që mbikëqyrësi gjatë tërë vitit të mos mbante një takim të dëshmuar me prova lidhur me diskutimin për realizimin e objektivës 3 (tre) të përcaktuar në planin e punës së ankueses, andaj Kolegji konstaton se kjo pikë e vlerësimit duhet të konsiderohet si vlerësim mire, pasi që mbikëqyrësi ka dështuar të argumentoj me prova dhe dëshmi se vlerësimi në pikën 3 (tre) është i bazuar dhe se ankuesja nuk ka realizuar objektiven për të cilën është vlerësuar me notën 1.

Kolegji konstaton se janë disa faza të vlerësimit të cilat duhet të zbatohen dhe të argumentohen me prova dhe dëshmi me qëllim që i gjithë procesi të jetë i argumentuar, gjithashtu në këtë rast Kolegji merr parasysh edhe ndryshimin në mesë të vlerësimit të ankueses për vitin 2019, 2020 në raport me vlerësimin e vitit 2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi i ka shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet relevantë, ka vendos në dispozitën e vendimit të Këshillit me të cilin, ka shfuqizuar vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesen dhe ka ndryshuar vlerësimin e rezultateve në punë vetëm sa i përket objektivës së 3 (tretë) të vlerësimit i cili vlerësim për këtë objektiv pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi është "mirë", duke u bazuar në nenin 13, paragrafi 4, të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se; 4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit).

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*

*Lënda Nr. A. Nr. 160/2022*

*Rushit KAJTAZI*

*Procesmbajtës*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencia Kundër Korrupsionit;
- Udhëheqësit të Personelit tek Agjencia Kundër Korrupsionit;
- Arkivit të KPMSHCK-së,